



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	04.06.2021	viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHK	2880/2021		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A nr.371/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arditë Haxhnikaj Demi- kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Zyle Millaku-Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.3056/2019 të datës 26.04.2021 të Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën e datës me numër A.nr.749/2019 të datës 05.12.2019 të parashtruar nga ankuesi , të cilin me autorizim e përfaqëson avokat Naim Aliu, me adresë Rr."Bulevardi Dëshmorët e Kombit" 72/2, Prishtinë, kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike „kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 03.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.749/2021 e datës 05.12.2019, e parashtruar nga

A r s y e t i m

Ankuesi tani i pensionuar, me datë 05.12.2019 ka parashtruar ankesë më numër protokollit 5678/2019 të regjistruar me A.nr.749/2019, kundër njoftimit me numër referencë 14-070/01-024915/19 të datës 25.10.2019 të Komisionit të Ankesave të Komunës së Prishtinës me pretendimet ankimore se bazuar në Ligjin Nr.03/L-2012 të Punës si dhe Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive, ankuesi ka të drejtën e tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në mungesë të kuorumit për vendosje ka udhëzuar ankuesin për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ. Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, më datë 26.04.2021 ka nxjerr Aktgjykimin A.nr.3056/2019, ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që të shqyrtoj dhe të vendos për ankesën e datës 05.12.2019 të parashtruar nga ankuesi

Kolegji për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Aktgjykimin A.nr.3056/2019 të datës 26.04.2021 të Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative; Ankesën A.nr.749/2019 të datës 05.12.2019 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 11.11.2019 i përfaqësuesit të autorizuar avokat Vendimin me numër 14-118/02-220676/19, i Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Njoftimi të datës 25.10.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Prishtinës; Akt emërimit e ankuesit të datës 01.02.2017 me nr. 01-nr.112-165 ; Vendimin nr.15 i datës i datës 04.03.2019 për përvojë të punës; -Emaili datës 21.05.2021; Kërkesë e datës 16.12.2019 me nr. protokoli 5831/2019 nga KPMSHCK-së drejtuar Komunës së Prishtinës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të të gjithave shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa lejuar, sepse është e parashtruar jashtë afatit të paraparë ligjor.*

Bazuar në shkresat e lëndës rezulton se ankuesi ka qenë i punësuar në Komunën e Prishtinës në pozitën "Zyrtar për Emergjencë", në Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim. Përmes Vendimit me numër 14-118/02-220676/19 të datës 09.09.2019, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, ankuesit i është përfunduar marrëdhënia e punës me datë 11.10.2019, për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, duke i njohur edhe të drejtën e kompensimit të pagës mujore në vlerë të një (1) page mujore.

Ankuesi kundër Vendimit me numër 14-118/02-220676/19 të datës 09.09.2019, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, me datë 10.10.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Prishtinës, ndërsa ky i fundit përmes Njoftimit me numër referencë 14-070/01-024915/19 të datës 25.10.2019, ka udhëzuar të njëjtin që në pajtim me nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtaret Publik, të parashtroj ankesë drejtpërdrejtë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Pas pranimit me datë 31.10.2019 të Njoftimit me numër referencë 14-070/01-024915/19 të datës 25.10.2019, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Komunën e Prishtinës, ankuesi parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se ankuesi ka të drejtën e tri pagave përcjellëse jubilarë ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr.03/L-2012 të Punës si dhe Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 3 të këtij Ligji, çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht neni 127 paragrafi 1 përcakton se: *1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.*

Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe duke marrë parasysh se ankuesi lidhur me të drejtën e parashtrimit të ankesës drejtpërdrejt në Këshill është njoftuar me datë 31.10.2019 përmes Njoftimit me numër reference 14-070/01-024915/19 të datës 25.10.2019, Kolegji konstaton se ankesa e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 05.12.2019, është ushtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.



Pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda A.nr.371/2021

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet :

- Përfaqësuesit të autorizuar Avokatit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.